REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E DREJTËSISË**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MONITORIMIT**

**DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

Nr. 1462 prot. Tiranë, më 04.12.2025

**URDHËR**

**Nr. 162, datë 04.12.2025**

**PËR**

**"ORGANIZMIN E PROGRAMIT TË TRAJNIMIT TË DETYRUESHËM PËR PËRMBARUESIT GJYQËSORË NË PERIUDHË PROVE PRANË SHËRBIMIT PËRMBARIMOR GJYQËSOR SHTETËROR"**

Në mbështetje të nenit të 8 dhe 19, të ligjit nr. 8, datë 2.2.2023 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Giyqësor Shtetëror"", Urdhërit të Ministrit të Drejtësisë nr. 433, datë 30.06.2023 "Për përcaktimin e rregullave për Organizimin dhe përmbajtjen e programit të trajnimit, pjesmarrjen në trajnime si dhe testimin e njohurive të përfturara për përmbaruesit gjyqësor shtetërorë në periudhë prove" si dhe për të mundësuar aftësimin profesional të 2(dy) përmbaruesve giyqësor shtetëror në periudhë prove:

**URDHËROJ:**

1. Programi i trajnimit të detyrueshëm për 2 (dy) përmbaruesit gjyqësor shtetëror në periudhë prove do të realizohet nga institucioni i Drejtorisë së Përgjithshme e Përmbarimit, Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror:

2. Stafi trajnues i përmbaruesve giyqësor shtetëror në periudhë prove, përzgjidhen nga stafi i punonjësve të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, të identifikuar për formimin dhe aftësitë e tyre në njohjen dhe zbatimin e ligjit, si më poshtë:



Scanned with CamScanner

- **Entela TOÇI** Zv/Drejtor i Përgjithshëm/Drejtor, Drejtoria e Inspektimit
- **Laura BARJAMI** Drejtor, Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse
- **Sonila DAJA** Inspektor/Drejtoria e Inspektimit
- **Olta SHKËMBI** Kryetar Zyre/Përmbarues giyqësor, Zyra Përmbarimore, Korçë,
- **Fitim KOÇIAJ** Kryetar Zyre/Përmbarues giyqësor, Zyra Përmbarimore, Vlorë

3. Programi i detyrueshëm i trajnimit fokusohet në aftësimin profesional teorik dhe praktik të përmbaruesve giyqësorë në periudhë prove, nëpërmjet trajtimit të temave mbi Kodin e Procedurës Civile, Kodin Civil, etikën profesionale si dhe legjislacionin në tërësi që rregullon veprimtarinë e shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror dhe zhvillimit të moduleve të trajnimit të miratuara.

4.Trajnimi i detyrueshëm për përmbaruesit gjyqësor shterëror në periudhë prove do të organizohet 5 (pesë) ditë në javë dhe me kohëzgjatje 200 orë sipas programit tematik dhe kalendarit të aktiviteteve trajnuese, sipas Aneksi 1, që i bashkëlidhet këtij urdhëri.

5, Trajnimi do të organizohet në mënyrë të kombinuar, në ambjentet e institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, në adresën: Sheshi "Mustafa Qemal Ataturk", Tiranë dhe online nëpërmjet platformës "teams".

6. Përmbaruesit gjyqësorë shtetëror në periudhë prove që do të ndjekin trajnim e detyrueshëm të organizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit janë:

*-Mikeda Cenaj* *Përmbarues gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Tiranë*

*- Andrit Elezi* *Përmbarues gjyqësor pranë Zyrës Përmbarimore Kukës*

7. Pjesmarrja e përmbaruesve në trajnim do të evidtentohet nëpërmjet nënshkrimit nga ana e tyre të listëprezencës dhe për ratet e trajnimit në distancë pjesmarrja do të evdientohet nëpërmjet konfimimit të trajnuesit elektronik.

8. Njoftimi për pjesmarrje në trajnim do të evidentohet nëpërmjet publikimit të kalendarit të aktiviteteve të trajnimit në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit. Publikimi në faqen zyrtare është i barasvlefshëm me njoftimin.

9. Provimi për kontrollin e njohurive të fituara gjatë trajnimit të detyrueshëm do të organizohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, në përfundim të programit të detyrueshëm. Në bazë të moduleve të trajnimit të zhvilluar.



Scanned with CamScanner

10- Me zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, nëpunësit e caktuar si trajner në pikën 2 të këtij urdhëri, përmbaruesit gjyqësor në pikën 6, Specialisti i IT-i pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit si dhe Kryetari i Zyrës Përmbarimore Tiranë dhe Kukës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**Ergys QIRICI**



Scanned with CamScanner

| Emërtimi i Modulit | Nën moduli/ Temat | Orë trajnimi | Data e trajnimit | Trajner | Vendi |
|---|---|---|---|---|---|
| **Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor në Shqipëri** | *Organizimi dhe Funksionimi i Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.*<br>*Parimet bazë në kryerjen e veprimtarisë përmbarimore.*<br>*Kompetencat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.*<br>*Kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryetarit të Zyrës Përmbarimorë.*<br>*Të drejtat dhe detyrimet e përmbaruesve gjyqësor shtetëror.*<br>*Papajtueshmëritë me funksionin e përmbaruesit gjyqësor. konflikti i interesit, konfidencialiteti, praktika të ndaluara.*<br>*Raste nga praktika* | 16 orë | 10.12.2025 – 11.12.2025 | Entela Toçi | DPP |
| **Pranimi në Shërbimin Përmbarimor dhe vlerësimi i përmbaruesve gjyqësor dhe kryetarëve të zyrave përmbarimorë** | *Kushtet për pranimin në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.*<br>*Procesi i përzgjedhjes, provimi i pranimit në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor.*<br>*Roli i Këshillit të Përmbarimit.*<br>*Trajnimet e përmbaruesve gjyqësor.*<br>*Programi i trajnimit të detyrueshëm për përmbaruesit në periudhë prove.*<br>*Trajnimi vazhdues i përmbaruesve gjyqësor.* | 16 orë | 16.12.2025-17.12.2025 | Laura Barjami | Online |

Scanned with CamScanner

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Masat e marra për efektivitetin e veprimtarisë përmbarimorë** | *Plani i Punës për Uljen e dosjeve të mbartura.*<br><br>*Masat e parashikuara.*<br><br>*Kuadri Kohor.*<br><br>*Zbatimi i këtyre masave nga përmbaruesit gjyqësor*<br><br>*Monitorimi i zbatimit të këtyre masave.* | 16 orë | 23.12.2025-24.12.2025 | Entela Toçi | Online |
| **Kuadri Ligjor i zbatueshëm në Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror.** | *Legjislacioni për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv.*<br><br>*Kodi i Procedurës Civile.*<br><br>*Kodi Civil*<br><br>*Kodi i Procedurës Penale*<br><br>*Ligji nr. 79/2020 per ekzekutimin e vendimeve penale.*<br><br>*Ligji për shoqëritë tregtare.*<br><br>*Ligji për dhunën ne familje etj.*<br><br>*Si ndërthuren këto akte ligjorë dhe jo vetëm ne vëprimtarinë përmbarimorë të përmbaruesve gjyqësor më funksion të ekzekutimit të vendimeve gjyqësorë.*<br><br>*Raste nga praktika.* | 24 orë | 06.01.2026-08.01.2026 | Olta Shkëmbi | Online |
| **Kriteret e vlerësimit etik dhe professional të përmbaruesve gjyqësor dhe Kryetarëve të Zyrave Përmbarimorë** | *Kriteret e vlerësimit etik dhe profesional të përmbaruesve gjyqësor dhe kryetarëve të zyrave përmbarimorë.*<br><br>*Parimet e vlerësimit.*<br><br>*Qëllimi i vlerësimit*<br><br>*Burimet e vlerësimit.*<br><br>*Formularët e vetvlerësimit*<br><br>*Roli i Këshillit të Përmbarimit.* | 16 orë | 08.01.2026-09.01.2026 | Laura Barjami | Online |

Scanned with CamScanner

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Ekzekutimi i titujve ekzekutiv** | *Kriteret e ligjit procedurial për regjistrimin e titujve ekzekutiv pranë zyrave përmbarimorë.*<br>*Rastet përjashtimorë të parashikuara nga legjislacioni të cilat nuk kanë nevojë për pasijen me Urdhër Ekzekutimi.*<br>*Ekzekutimi i përkohshëm.*<br>*Masat e sigurimit.* | 16 orë | 12.01.2026-13.01.2026 | Fitim Koçiaj | online |
| **Mjetet e mbrojtjes nga veprimet përmbarimorë në fazën e ekzekutimit të detyrueshëm** | *Kundërshtimi i veprimeve përmbarimorë.*<br>*Padia për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv( neni 609il Kodit të Procedurës Civile)*<br>*Padia e personit të tretë(neni 613 i Kodit të Procedurës Civile)*<br>*Pasojat që sjellin në vijimin e procedurave përmbarimorë.*<br>*Raste nga praktika* | 16 orë | 19.01.2026.-20.01.2026 | Olta Shkëmbi | Online |
| **Veprimtaria përmbarimorë** | *Procedurat përmbarimorë që ndiqen për ekzekutimin e titujve ezkekutiv me objekte të ndryshme.*<br>*Procedurat e ankandit për shitjen e sendeve të luajtëshme dhe sendeve të paluajtëshme.*<br>*Inventarizimi i sendeve.*<br>*Pezullimi i veprimeve përmbarimore.*<br>*Pushimi i veprimeve përmbarimore* | 16 orë | 29.01.2026-30.01.2026 | Sonila Daja | Online |

Scanned with CamScanner

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Bashkëpunimi ndërinstitucional si nevojë e ekzekutimit të titujve ekzekutiv** | *Bashkëpunimi me institucionet si IKMT, DPSHTRR, ASHK, Policinë e Shtetit. Zyrat e Gjëndjes Civile.*<br>*Raste nga praktika* | 16 orë | 03.02.2026-04.02.2026 | Fitim Koçiaj | Online |
| **Procedimi displinor i përmbaruesit gjyqësor** | *Rastet e pezullimit të përmbaruesit gjyqësor.*<br>*Procedura që ndiqet për fillimin e hetimit disiplinor.*<br>*Dokumentacioni i hetimit.*<br>*Pezullimi i hetimit*<br>*Përfundimi hetimit etj.* | 16 orë | 09.02.2026-10.02.2026 | Entela Toçi | Online |
| **Procedura përmbarimorë që ndiqet për titujt ekzekutiv me objekt takim fëmije dhe pension ushqimor.** | *Veprimtaria procedurale për ekzekutimin e titujve ekzekutiv me objekt takim fëmije dhe pension ushqimor.*<br>*Rëndësia e psikologut në titujt ekzekutiv me objekt takim fëmije.*<br>*Ndalimi i shumës për palën debitorë për titujt ekzekutiv me objekt pension ushqimor.*<br>*Rëndësia e nenit 529 të Kodit të Procedurës Civile në rastte me objekt pension ushqimor.* | 16 orë | 16.02.2026-17.02.2026 | Olta Shkëmbi | Online |

Scanned with CamScanner

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Procedura përmbarimorë që ndiqet për titujt ekzekutiv me objekt gjobë penale dhe shpenzime gjyqësorë.** | *Veprimtaria procedurale për ekzekutimin e titujve ekzekutiv me objekt gjobë penale dhe shpenzime gjyqësorë.*<br>*Rastet që përfitojnë nga Ligji për Amnistinë.*<br>*Procedura që duhet të ndiqet nga përmbaruesit gjyqësor* | 16 orë | 23.02.2026-24.02.2026 | Entela Toçi | Online |

Scanned with CamScanner